



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1664/1 Prot.

Pustec më 26.11.2025

RAPORT PËRMBLEDHËS MBI ZHVILLIMIN NE DËGJESAVE PUBLIKE

Mbi Zhvillimin e Dëgjësive Publike për Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026–2028, Buxhetin 2026 dhe Paketën Fiskale 2026

Procesi i dëgjësive publike i organizuar nga Bashkia Pustec për hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, Buxhetit Vjetor 2026 dhe Paketës Fiskale 2026 ka përbërë një fazë të rëndësishme të dialogut mes institucioneve vendore dhe komunitetit. Synimi kryesor i këtij cikli konsultimesh ka qenë garantimi i transparencës, rritja e nivelit të pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirja e drejtpërdrejtë e banorëve në procesin e identifikimit të nevojave të tyre, vlerësimit të shërbimeve ekzistuese dhe përcaktimit të prioritetëve për periudhën e ardhshme buxhetore.

Përmes këtij procesi, Bashkia Pustec ka synuar të mbledhë sugjerime, vërejtje dhe rekomandime konkrete nga komuniteti, të cilat shërbejnë si bazë në hartimin e dokumenteve financiare, me theks të veçantë tek përshtatja e buxhetit me realitetin e zonës dhe rritja e efektivitetit të shërbimeve publike.

Dëgjesat janë organizuar në disa qendra të rëndësishme të bashkisë, duke siguruar përfshirje të gjerë territoriale dhe duke u mundësuar banorëve të shprehin opinione drejtpërdrejt nga komuniteti ku ata jetojnë.

Dëgjesa është zhvilluar në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ku kanë marrë pjesë kryetari i fshatit Pustec, Zaroshkë, Lajthizë, Goricë e Madhe dhe Gollomboc, ndërsa tre fshatra të tjerë kanë paraqitur kërkesat dhe rekomandimet e tyre me shkrim pranë Sekretarisë së Këshillit Bashkiak, duke dëshmuar ndërgjegjësimin dhe gatishmërinë e komunitetit për të kontribuar në procesin e menaxhimit të fondeve publike.

Takimi qendror i konsultimit publik është mbajtur më datë 26 nëntor 2025, në sallën e Këshillit Bashkiak në Pustec, duke filluar nga ora 10:00.

	Vendi	Ora	Data
1	Pustec	Në sallën e KB	10:00
			26.11.2025

Pjesëmarrës:

Në këtë aktivitet morën pjesë 15 banorë, përfaqësues nga administrata e bashkisë, kryetari dhe nënkryetari i bashkisë, anëtarë të Këshillit Bashkiak, specialistë të Zyrës së Financës dhe Zyrës së Tatim-Taksave, Koordinatorin për Konsultimin Publik, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, përfaqësues të Aleancës së Grave Këshilltare dhe institucione të tjera bashkiake. Nga

Nga komuniteti:

Nga ana e komunitetit morën pjesë kryetarë fshatrash, banorë të zonave përkatëse, përfaqësues të institucioneve arsimore dhe fetare, të biznesit lokal dhe të organizatave joqeveritare, duke krijuar një përfaqësim të gjerë dhe të balancuar të interesave të komunitetit.

Forma e konsultimit

Takim publik

Qëllimi i konsultimit publik është evidentimi i nevojave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike, bazuar në Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026–2028, Buxhetin 2026 dhe Paketën Fiskale 2026.

Gjatë takimeve u diskutua përdorimi i fondeve publike gjatë vitit 2025, niveli i realizimit të objektivave dhe performanca e shërbimeve bazë. Banorët u ftuan të shprehin mendimet e tyre mbi shërbimet që duhen përmirësuar, forcuar ose rikonceptuar për vitet 2026–2028, me synimin që prioritetet buxhetore të pasqyrojnë vërtetë kërkesat e komunitetit. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e diskutimit iu kushtua Paketës Fiskale 2026, ku u trajtuan çështje që lidhen me funksionimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, rregullsinë e pagesave dhe nevojën për një balancim më të drejtë të barrës tatimore për të gjitha kategoritë e banorëve.

Në dëgjuesën e organizuar në u paraqitën një sërë shqetësimesh që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës dhe mjedisit.

Në Goricë e Madhe banorët kërkuan pastrimin e përrenjve dhe gropave septike, vendosjen e tubacioneve në zonat bujqësore, ndërtimi i një ure kalime që lidh fshatin me tokat bujqësore, rregullimi i ndricimit të jashtëm,

Në Pustec u kërkuua ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe përmirësimin i cilësisë të ujit të pijshëm. U theksua nevoja për vendosjen e koshave të mëdhenj të plehrave, pastrimin e mbeturinave dhe

shtigjeve turistike. Një kërkesë e veçantë ishte asfaltimi i segmentit Pustec–Lajthizë dhe krijimi i një qendre multifunkSIONALE për promovimin e vlerave kulturore, ashtu si edhe forcimi i masave ndëshkuese ndaj personave që ndotin mjedisin ose lejojnë qarkullimin e bagëtive në hapësirat publike.

Në Zaroshkë, vëmendja u përqendrua tek rregullimi i rrugëve të brendshme të fshatit, pastrimi i kanaleve dhe përronjve, si dhe rritja e aksesit në transportin publik me propozimin që autobusi të kalojë të paktën një herë në javë. Banorët shprehën shqetësime për gropat septike të bllokuara dhe kërkuan riparimin e urës së fshatit.

Në Shulin (Diellas) u ngritën çështje që lidhen me rregullimin e kanalizimeve, çakullimin e rrugës që lidh qendrën me kishën, ndërtimin e një këndi sportiv dhe hapësirave rekreative për fëmijë, si dhe pastrimin e inerteve dhe materialeve të grumbulluara në disa lagje.

Në Tuminëc (Kallamas) kërkuan ndërhyrje urgjente për menaxhimin e qarkullimit të bagëtive brenda fshatit, duke kërkuar vendosjen e gjobave për shkelësit. Po ashtu u kërkuar çakullimi i rrugës drejt kishës, rregullimi i kanalizimeve, riparimi i mureve të dëmtuara dhe pastrimi i depozitës së ujit.

Në Dollna Goricë (Goricë e Vogël) banorët kanë ngritur nevoja për pastrimin e kanaleve përgjatë rrugëve, largimin e mbetjeve të ngurta dhe inerteve, rikonstruksionin e qendrës shëndetësore, sistemimin e kanalizimeve dhe rregullimin e rrugëve të brendshme.

Të gjitha sugjerimet e mbledhura përgjatë këtyre dëgjesave përbëjnë një burim të domosdoshëm informacioni për hartimin e politikave të zhvillimit dhe prioritetëve buxhetore të Bashkisë Pustec. Ky proces i strukturuar i konsultimit publik ka rritur transparencën, besueshmërinë institucionale dhe bashkëpunimin e komunitetit me strukturat drejtuese. Rekomandimet e dhëna nga banorët do të merren në shqyrtim gjatë fazës së finalizimit të dokumenteve buxhetore për vitin 2026 dhe për periudhën afatmesme 2026–2028, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, forcimin e zhvillimit lokal dhe rritjen e cilësisë së jetës në të gjitha zonat e bashkisë.



Në këtë mënyrë, Bashkia Pustec riafirmon angazhimin e saj për të vijuar me procese të rregullta dëgjese dhe konsultimi, duke garantuar që çdo banor të ketë mundësi të kontribuojë në formësimin e politikave dhe buxhetit të komunitetit të vet.

Sekretar i këshillit

Todora TËRPO

Kryetar i këshillit

Na um DAMO